



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 14 mars 2019  
Nr. ref.: RK 1335/19

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI70/18**

Parashtrues

**Alfred Zylfaj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të  
Kosovës, PML. nr. 120/17, i 13 dhjetorit 2017**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Alfred Zylfaj, nga Suhareka (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga avokatët Shpresa Berisha-Rexhepi dhe Ymer Osaj.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [PML. nr. 120/2017] të 13 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme të Kosovës.
3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 25 janar 2018.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara për çka pretendohet se parimi *refomatio in peius* është shkelur në dëm të parashtruesit të kërkesës në lidhje me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.1 dhe 7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 10 maj 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
9. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
10. Më 19 shtator 2018, Gjykata në pajtim me paragrafin 2 (c) të rregullit 33 [Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit] të Rregullores së punës, kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës që të dorëzon autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.

11. Më 5 nëntor 2018, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.
12. Më 20 dhjetor 2018, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë dëshminë (fletëkthesën) që tregon ditën e pranimin, nga parashtruesi i kërkesës, të aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.
13. Më 20 dhjetor 2018, Gjykata iu dërgoi nga një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykatës Themelore iu kërkua që të dorëzojë dëshminë (fletëkthesën) që tregon ditën e pranimin, nga parashtruesi i kërkesës, të aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.
14. Më 24 dhjetor 2018, Gjykata Themelore dorëzoi dëshminë për pranimin e aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.
15. Më 6 shkurt 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

16. Zanafilla e këtij rasti rrjedh nga akuza penale që rëndonte parashtruesin e kërkesës së bashku me disa individë tjerë kishte bërë thyerje të shtëpisë së R. G. me qëllim të vjedhjes dhe përftimit material të kundërligjshëm, me ç'rast po ashtu kishin qëlluar për vdekje R. G.
17. Më 16 shkurt 2011, Prokurori Publik i Qarkut ngriti aktakuzën PP. nr. 443-4/2000 kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale të vjedhjes grabitqare apo grabitjes parashikuar me nenin 256.2 në bashkëkryerje në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK). Parashtruesi po ashtu ishte akuzuar për mbajtje në pronësi të paautorizuar të armëve nga neni 328 (2) të KPK-së.
18. Më 17 mars 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykim PKR. nr. 24/13) e shpall fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak të veprës penale të vjedhjes grabitqare apo grabitjes parashikuar me nenin 256.2 në bashkëkryerje në lidhje me nenin 23 të KPK-së. Parashtruesi i kërkesës po ashtu u shpall fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi e paautorizuar e armëve nga neni 374.1 i KPK-së. Parashtruesit të kërkesës iu shqiptua dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite e (6) gjashtë muaj.
19. Gjykata Themelore në Prishtinë, pas vlerësimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte konstatuar: (i) se nga dëshmitë e palëve të dëmtuara A. G. dhe S. G. dhe dëshmitarit L. A. (bashkëkryes) gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë; (ii) se tek i akuzuari (parashtruesi i kërkesës) kishte ekzistuar paramendimi për kryerjen e veprës penale të vjedhjes grabitqare apo grabitjes; (iii) se ekzistojnë elementet e veprës penale për mbajtje në pronësi të paautorizuar të armëve dhe se i akuzuari kishte përdorur revolen (kalibër 7,65 mm) në çastin kur ka qëlluar për vdekje R. G.; (iv) mbrojtja e të akuzuarit është hedhur poshtë plotësisht e pabazuar për shkak se bie në kundërshtim me të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor; (v) raporti i njësisë teknike-kriminalistike vërteton se gjurmët e fiksuara i përkasin gjurmëve të

shuplakës së të akuzuarit; (vi) raporti i autopsisë nga mjeku ligjor ka vërtetuar se shkak i vdekjes së R. G. janë plagët në gjoks nga të shtënat me armë; dhe, se (vii) duke pasur parasysh gjendjen faktike dhe provat e administruara, Gjykata Themelore është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj veprimeve inkriminuese të të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit siç parasheh neni 41 i KPK-së.

20. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që Gjykata e Apelit ta miratojë ankesën dhe vendimin e goditur ta anuloj dhe çështjen ta kthejë në rigjykim.
21. Prokuroria Themelore-DKR në Prishtinë i propozoi Gjykatës së Apelit që ta ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që parashtruesit të kërkesës t'i shqiptohet dënim më i lartë me burgim.
22. Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën (PPA/I. nr. 453/2014, më 12 shtator 2014) propozoi që të miratohet ankesa e lartpërmendur e Prokurorit Themelor në Prishtinë, për shkak të vendimit mbi sanksionet penale dhe parashtruesit të kërkesës t'i shqiptohet dënim më i lartë me burgim.
23. Më 9 tetor 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendim PAKR. nr. 440/2014) aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, dhe sipas detyrës zyrtare, anuloi aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Themelore dhe çështjen penale e ktheu në rigjykim. Rrjedhimisht, ankesa e Prokurorit Themelor ishte shpallur "jолëndore". Gjykata e Apelit, në thelb, arsyetoi: *"Gjykata nuk jep sqarime të mjaftueshme për veprimet inkriminuese dhe përgjegjësinë penalo-juridike, e duke u nisur se veprën penale e kanë kryer në bashkëkryerje ku kanë marrë pjesë katër të akuzuar, duke u nisur nga ajo se veprat penale të kryera në bashkëkryerje janë vepra penale komplekse, gjykata nuk jep sqarime se të akuzuarit në cilën formë të bashkëkryerjes kanë vepruar dhe fare nuk sqarohet kontributi i tyre në kryerjen e veprës penale dhe gjykata nuk jep asnjë fakt se të akuzuarit përgjigjen për veprimet e tyre në kuadër të qëllimit të dashjes së tyre dhe se këndejmi dhe përgjegjësia penalo-juridike duhet të jetë e ndryshme për secilin të akuzuar"*.
24. Më 6 korrik 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykim PKR. nr. 552/14) shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës: (i) për shkak të vjedhjes grabitqare apo grabitjes në bashkëkryerje nga neni 256.2 në lidhje me nenin 23 të KPK-së dhe i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 19 (nëntëmbëdhjetë) vite e 6 (gjashtë) muaj; (ii) për shkak të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374.1 i KPK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti; dhe (iii) konform nenit 80.1 dhe 2 të KPRK-së, për dy vepra penale, e gjykon me dënim unik me burgim prej 20 (njëzet) vitesh.
25. Gjykata Themelore në aktgjykimin e lartpërmendur prej 23 faqesh shpjegoi se vendimin për dënimin me burgim të parashtruesit të kërkesës e bazoi në një mori dokumentesh siç janë: deklaratat e dëshmitarëve bashkëkryes, deklaratat e të dëmtuarve, raportin e autopsisë së viktimës R. G., raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, raportit të ekspertizës, foto-dokumentacionit në shkresat e lëndës,

leximin e ballafaqimit ndërmjet të bashkëkryesve si dhe ballafaqimin e tyre, memorandumit zyrtar, lista e dëshmime, raporti i teknikës kriminalistike etj.

26. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që Gjykata e Apelit ta miratojë ankesën dhe vendimin e goditur ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim. Parashtruesi i kërkesës, në veçanti, pretendoi se: *“Në aktgjykim nuk janë vlerësuar provat, për arsye se nuk janë paraqitur faktet vendimtare dhe se të akuzuarit i është shqiptuar dënimi prej 20 viteve dhe është shkelur parimi “reformatio in pieus”, e kjo nënkupton se ndalohet ndryshimi i vendimit gjyqësor dhe keqësimin e pozitës së të akuzuarit në rastet kur paraqitet mjeti juridik në dobi të të akuzuarit, kjo për arsye se ankesat e PTH-DKR në Prishtinë nga Gjykata e Apelit, është deklaruar si jo lëndore për arsye se prokuroria nuk ka ushtruar ankesë mbi gjendjen e fakteve”*.
27. Prokurori Themelor në Prishtinë po ashtu paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar dënim më të ashpër për parashtruesin e kërkesës dhe duke pasur parasysh pasojat e veprës penale, prirjet kriminale të parashtruesit të kërkesës dhe të akuzuarve tjerë dhe rrezikshmërinë e lartë shoqërore të tyre.
28. Më 6 shkurt 2017, Gjykata e Apelit (Aktgjykim PAKR. nr. 5/2017) aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore për sa i përket cilësimit të veprës penale duke e ricilësuar në raste të rënda të vjedhjes grabitqare apo grabitjes, nga neni 256.2 në lidhje me nenin 23 të KPK-së. Parashtruesit të kërkesës iu shqiptua dënimi unik në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) vjet, duke iu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim. Ankesa e Prokurorit Themelor në Prishtinë u refuzua e pabazuar.
29. Gjykata e Apelit në përgjithësi miratoi vërtetimin e fakteve dhe administrimin e provave nga Gjykata Themelore, kurse për pretendimin për shkelje të parimit *“reformatio in pieus”*, u shpreh: *“Pretendimet ankimore të të akuzuarve [...] se është shkelur ndalesa “reformatio in pieus”, nga neni 395 të KPP-së, nuk qëndrojnë për arsye se ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, jolëndore nuk nënkupton se dënimi nuk mund të ashpërsohet, kjo për arsye sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktvendimi PAKR. Nr. 440/2015 të datës 09.10.2014, është anuluar sipas ankesave të mbrojtësve edhe sipas detyrës zyrtare dhe ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, ka mbetur e pavlerësuar (e pashqyrtuar), pra ankesa ka ekzistuar dhe kjo nënkupton se Gjykata e shkallës së parë, megjë ka ekzistuar ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, nuk ka qenë e ndaluar me ndalesën “reformatio in pieus”, nga neni 395 të KPP, kur të akuzuarve ju ka shqiptuar dënime më të ashpra”*.
30. Për sa i përket proporcionalitetit ndërmjet dënimit dhe rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, Gjykata e Apelit konstatoi: *“Gjykata e Apelit ankesën e paraqitur nga ana e PTH-DKR në Prishtinë, e ka refuzuar si të pabazuar, e sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, në masë të duhur i ka vlerësuar të gjitha rrethanat si ato rënduese dhe ato lehtësuese, me rastin e marrjes dhe matjes së dënimit, me vlerësimin e rrethanave të përgjithshme mbi matjen e dënimit të paraparë si në nenin 73*

*KPRK, e duke marrë parasysh se vepra penale është kryer për shkak të lakmisë dhe me pasojë të rënda, e me privimin e të ndjerit, të dy vlera mbrojtëse privimi nga jeta dhe mbrojtja e pasurisë gëzojnë mbrojtje penale-juridike si vlera më e madhe mbrojtjes juridike-penale, dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve Alfred Zylfaj, Sh. K., M. K. dhe S. D., është në proporcion me peshën e veprave penale të kryera dhe shkallën e përgjegjësisë penalo-juridike të tyre dhe dënimet e këtilla të shqiptuara do t'i shërbejnë preventivës individuale që t'i parandalojë të akuzuarit nga kryerja e veprave penale të këtilla dhe të ngjashme, si dhe t'i shërbejë preventivës së përgjithshme që t'i parandalojë të tjerët në kryerjen e veprave penale të këtilla dhe të ngjashme dhe pritët të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 41 KPRK-së”.*

31. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimet e goditura të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim. Parashtruesi i kërkesës veçanërisht ishte ankuar: (i) për zvarritje të procesit nga padia penale deri në vendimin e shpallur nga Gjykata Themelore kishin kaluar 4 (katër) vite; (ii) mungesë e arsytimit adekuat për ashpërsim të dënimit të parashtruesit të kërkesës; dhe, (iii) përkeqësim të pozitës procedurale të parashtruesit të kërkesës për shkak të shkeljes së parimit “*reformatio in peius*”.
32. Më 2 dhe 13 qershor 2017, Prokurori i Shtetit (shkresë KMLP. II. nr. 82/2017) i kishte propozuar Gjykatës Supreme që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës të refuzohet e pabazuar.
33. Më 13 dhjetor 2017, Gjykata Supreme (Aktgjykim PML. nr. 120/2017) refuzoi të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR. nr. 552/2014, të 6 korrikut 2016 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 5/2017, të 6 shkurtit 2017. Gjykata Supreme vlerësoi se nuk ka shkelje të dispozitave procedurale penale apo shkelje të ligjit penal nga gjykatat e instancës më të ulët; dhe se ato, kishin vlerësuar prova të shumta siç janë dëshmitë e dëshmitarëve, raporti i autopsisë, rikonstruktimi i vendit të ngjarjes, ballafaqimi i të akuzuarve etj.
34. Për sa i përket veprimeve inkriminuese të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme kishte konstatuar: “*veprimet inkriminuese të të dënuarve Alfred Zylfaj dhe SK, për secilin veç e veç, përmbushen elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374. par. 1 të KPK-së. Kjo gjykatë, pranon qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë të shprehura në aktgjykimet e kundërshtuara përkitazi me përgjegjësinë penale të të dënuarve, se në veprimet e tyre qëndrojnë elementet qenësore të veprës penale rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 256 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së”.*
35. Për sa i përket përgjegjësisë penale të parashtruesit të kërkesës dhe bashkëkryesve tjerë, Gjykata Supreme kishte konstatuar: “[...] Kryesore është që

çdo bashkëkryes ta dijë që krahas tij, në kryerjen e veprës penale marrin pjesë edhe persona të tjerë të caktuar. Në kërkesa nuk ishte paraqitur ndonjë fakt, por as në shkresat e lëndës nuk ekzistonte ndonjë provë, që kishte me vënë në dilemë përgjegjësinë penale të të dënuarve, rrethanë për përjashtimin e përgjegjësisë penale eventualisht do të kishte kur kemi të bëjmë me kryerësit e pallogaritshëm apo kemi të bëjmë me lajthim faktik dhe juridik, mirëpo në rastin konkret asnjë nga këto kondita nuk janë plotësuar. Për këto arsye edhe pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve se është shkelur ligji penal në këtë drejtim u refuzuan si të pabazuara”.

36. Për sa i përket zvarritjes së procesit nga dita e padisë penale deri në shpalljen e vendimit të Gjykatës Themelore, Gjykata Supreme u shpreh: “*Pretendimet nga kërkesa e mbrojtësve të të dënuarit Alfred Zylfaj, se gjykata nuk ka dhënë arsye për zgjatjen e këtij gjykimi qëndrojnë dhe është fakt se gjykimi ka zgjatur, mirëpo kjo zgjatje nuk ka ndikuar në mënyrën e vendosjes dhe në këtë aspekt pretendimi është i pabazuar*”.
37. Për sa i përket shkeljes së parimit “*reformatio in peius*”, Gjykata Supreme arsyetoi: “*Pretendimet nga kërkesat e mbrojtësve se është shkelur dispozita e nenit 384 par. 1 nënparagrafi 1. 11 lidhur me nenin 395 të KPP-së, nuk qëndrojnë. Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR. nr. 440/2015 të datës 09.10.2014, aktgjykimi i shkallës së parë është anuluar me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve dhe sipas detyrës zyrtare, ndërsa ankesa e PTH-DKR Prishtinë ka mbetur e pashqyrtuar dhe e pavlerësuar; pasi që çështja është anuluar dhe është kthyer në rigjykim. Andaj, ankesa e PTH-DKR Prishtinë ka ekzistuar dhe kjo nënkupton se gjykata e shkallës së parë, meqë ka ekzistuar ankesa (e PTH-DKR Prishtinë), gjykata nuk ka qenë e kufizuar me ndalesën reformatio in peius nga neni 395 i KPP-së kur e ka ndryshuar vendimin për dënimin dhe të akuzuarve u ka shqiptuar dënime më të ashpra dhe se në këtë drejtim nuk është shkelur dispozita ligjore e nenit 395 të KPP-së*”.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e zakonshme kanë shkelur parimin *reformatio in peius* i parashikuar me nenin 395 të KPP-së.
39. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është cenuar siguria juridike në ushtrimin e mjetit juridik sepse në rivendosje të çështjes Gjykata Themelore nuk ka pasur të drejtë që të shqiptoj dënim më të ashpër se sa ishte shqiptuar me aktgjykimin e parë. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se parimi *reformatio in peius* ishte shkelur edhe nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e Kosovës.
40. Parashtruesi i kërkesës pohon: “*parimi reformatio in peius përbën privilegjin më të rëndësishëm të të pandehurit [...] baza e ndalimit reformatio in peius është drejtësia, d.m.th garancia që i jepet të akuzuarit se ankimi i bërë në favor të tij, nuk mund të veprohet në dëm të tij [...]. Dhe në rastin konkret ankimi i bërë në favor të akuzuarit ka përkeqësuar pozitën e tij*”.
41. Parashtruesi i kërkesës pretendon: “*Në rastin Alfred Zylfaj [...] ankesa e prokurorit është paraqitur jolëndore, që do të thotë se ende nuk është shqyrtuar*

*çështja sa i përket sanksionit penal; sanksioni penal do të bëhej lëndor pas eliminimit të metave të Aktgjykimit të shkallës së parë, ndërsa gjykata merr vendimin e dytë lidhur me sanksionin penal pa u shqyrtuar i pari, që i bie se është marrë vendim mbi vendim e që është e ndaluar [...] në këtë situatë juridike gjykata sillet me vendimin mbi sanksionin penal sikurse nuk e ka marrë fare”.*

## **Dispozitat ligjore relevante**

### **KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE**

*Neni 395  
Reformatio in Peius*

*Në qoftë se është paraqitur ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit, aktgjykimi përsa i përket cilësimit juridik të veprës dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të tij.*

## **Pranueshmëria e kërkesës**

42. Gjkata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
43. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

44. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

*Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]*

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”*

45. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e parashikuar në nenin 49 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës po ashtu saktësisht ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë cenuar dhe aktet e autoriteteve publike që i konteston në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit.
46. Nga sa u tha më sipër, Gjykata shërbehet edhe me rregullin 39 (2) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, çka është në funksion të vërtetimit nëse parashtruesi i kërkesës dëshmon dhe mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
47. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës, specifikon:
- “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
48. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të parimit *“reformatio in peius”* në dëm të tij, d.m.th., shfrytëzimi i të drejtës për t’u ankuar nuk guxon që ta përkeqësojë pozitën e tij procedurale. Gjykata rithekson pretendimin e parashtruesit të kërkesës: *“parimi reformatio in pieus përbën privilegjin më të rëndësishëm të të pandehurit [...] baza e ndalimit reformatio in pieus është drejtësia, d.m.th. garancia që i jepet të akuzuarit se ankimi i bërë në favor të tij, nuk mund të veprohet në dëm të tij [...] Dhe në rastin konkret ankimi i bërë në favor të akuzuarit ka përkeqësuar pozitën e tij”.*
49. Gjykata vëren se parimi *“reformatio in peius”* gëzon mbrojtje nga neni 31 i Kushtetutës në kombinim me nenin 6 të KEDNJ-së sepse ka të bëjë me të drejtën e individit për t’u ankuar.
50. Çështja nëse është shkelur ose jo parimi *“reformatio in peius”* do të shtjellohet në paragrafët e mëposhtëm duke marrë parasysh: (i) procedurat e zhvilluara në tërësinë e tyre; (ii) kriteret dhe kufizimet e procedurës kushtetuese në rastet individuale; dhe, (iii) jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), duke pasur parasysh nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.
51. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se praktika e GJEDNJ-së përcakton se drejtësia e një procedure vlerësohet në tërësi. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t’i përmbahet këtij parimi. (Shih, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, rasti nr. KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin nr. KI143/16,

parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).

52. Në këtë drejtim, për t'i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtruesve të kërkesës, duhet pasur parasysh se “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në kushte të njëjta në gjykatë. (Shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, rasti nr. KI42/16 parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).
53. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Prokurori Themelor ka kërkuar dënim më të ashpër për parashtruesin e kërkesës në dy instanca gjyqësore. Gjykata po ashtu vëren se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë vlerësuar se kushti formal për mosshkelje të parimit “*reformatio in peius*” nga neni 395 KPP-së është përmbushur me paraqitje të ankesave të Prokurorit Themelor. Veç kësaj, Gjykata po ashtu vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është anuluar me aprovimin e ankesave të parashtruesit të kërkesës dhe sipas detyrës zyrtare, dhe rrjedhimisht, ankesa e PTH-DKR Prishtinë ka mbetur e pashqyrtuar dhe e pavlerësuar (shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Rasti Nr. KI45/16, *Parashtrues Muhamet Nikqi dhe Arbnor Nikqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 shkurtit 2017, paragrafët 29-33).
54. Gjykata vëren se në rastin konkret dënimi më i ashpër ndaj parashtruesit të kërkesës është caktuar në rigjykim nga Gjykata Themelore çka është çështje diskrecionale e gjykatave të rregullta. Gjykata, në pajtim me rolin subsidiar të saj në rastet individuale, konsideron se gjykatat e rregullta kanë arsyetuar mjaftueshëm pse në rastin konkret nuk është shkelur parimi “*reformatio in peius*” në dëm të parashtruesit të kërkesës (shih paragrafët 28 dhe 35 më lart).
55. Gjykata po ashtu vëren se gjykatat e rregullta kanë zbatuar testin e proporcionalitetit ndërmjet ashpërsisë së dënimit, rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe efektit të dënimit për parandalimin e kryerjes së veprave penale të ngjashme në të ardhmen (shih paragrafi 29 më lart).
56. Veç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqes argumente dhe dëshmi që ai i konsideroi relevante për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestoj në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. (Shih, ndër të tjera, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, rasti nr. KI118/17, parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

57. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka çuar një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, rasti nr. KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
58. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës së zhvilluar në gjykatat e rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, rasti nr. KI56/17, parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
59. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimet e kontestuara janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ. (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
60. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të deklarohet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 6 shkurt 2019, njëzëri

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Vjosa Rama-Hajrizi